

## Prokurë të posaçme

Për t'u pajisur me prokurë të posaçme, duhet që ju të aplikoni on-linë përmes internetit (nga një celular, tablet apo një kompjuter) në portalin [www.e-albania.al](http://www.e-albania.al).

Për të vijuar me aplikimin elektronik, klikoni në lidhjen si më poshtë:

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=9783](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9783)

Pasi të keni kryer aplikimin elektronik, jeni të detyruar të paraqiteni në Zyrën Konsullore për të firmosur në prezencë të konsullit procesverbalin e dorëzimit të kërkesës dhe për të dorëzuar dokumentet origjinale.

### Dokumentacioni i nevojshëm:

- 1.Fotokopje e dokumentit të identifikimit të personit që do të autorizohet
- 2.Dokument identifikimi (pasaportë ose kartë identiteti shqiptare) të aplikantit
- 3.Dokumente mbështetëse me të cilat justifikohet mjaftueshëm objekti i prokurës (psh kur bëhet fjalë për prokurë të Posaçme me objekt tërheqje pensioni pleqërie, librezë e pensionit ose vërtetimi nga Zyra Sigurimeve Shoqërore që trajtohet me pension ose ekstrakt bankar i tërheqjes së lekëve)

Mangësia e dokumentacionit në sistem si dhe gjatë paraqitjes së aplikantëve në Zyrën Konsullore shkakton vonesa ose mosmarrjen e shërbimit të kërkuar. Për këtë arsye jeni të lutur të respektoni kriteret e kërkuara nga sistemi.

Kostoja e shërbimit është 20 euro. Paguesa mund të kryhet me CASH në bankomatin e vendosur në ambientet e Zyrës Konsullore, të përshtatur edhe në gjuhën shqipe ose me çdo lloj kartë bankare nëpërmjet aparaturave POS.

### Prokurat e lejuara për lëshim nga nëpunësit konsullor:

- prokura të thjeshta, të cilat janë prokura të posaçme për veprime të thjeshta përfaqësimi dhe që nuk synojnë lindjen, ndryshimin ose shuarjen në thelb të të drejtave dhe detyrimeve të të përfaqësuarit.
- prokura për tërheqje dokumentesh të Gjendjes Civile në Shqipëri, shpallje martese, tërheqje pasaporte, tërheqje diplomash dhe dokumente shkollorë, tërheqjen e dëshmive të penalitetit si dhe tërheqjen e dokumenteve pranë autoriteteve private, etj.
- prokura për ndjekjen e veprimeve administrative dhe regjistrimin e akteve të Gjendjes Civile, si regjistrime lindjesh, martese, ndarje nga trangu familjar, denoncimin e humbjes së dokumenteve (kur shteti pritës nuk pranon marrjen e denoncimeve të kësaj natyre), procedura për legalizimin e shtëpive (pranë ALUIZNI-t) ose të ngjashme me to dhe tërheqjen e dëmshtëpërblimit të të përndjekurve, etj.
- prokurat për tërheqje pensioni, përdorim të përkohshëm automjeti dhe kryerjen e formaliteteve për qiradhënie të objekteve të banimit, etj. - prokura për përfaqësimin në proces gjyqësor për çështje divorci dhe për njohje të vendimeve të një gjykate të huaj, në Shqipëri; (p.sh. njohjen e vendimit të divorcit të bërë në një shtet të huaj, etj.)

Prokurat që nuk lejohen të lëshohen nga nëpunësit konsullor:

- prokura të përgjithshme.
- prokura për kontrata që kanë të bëjnë me kalimin e pronësisë të sendeve të luajtshme; (p.sh, kontrate shitblerje apartamenti apo prone etj.)
- prokura për kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme; (p.sh, kontrate shitblerje makine etj.)
- prokura për të drejtat e uzufruktit, përdorimit e bujtjes, enfiteozës e servitutit dhe të drejta të tjera reale; - prokura për kontrata garancie mbi përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata me veprime juridike;
- si dhe çdo prokurë tjetër që nuk është listuar në prokurat e lejuara për lëshim nga nëpunësit konsullor